⁴Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional oe duhet të dorëzojë:

Licensa profesionale e shoqërisë , të lëshuar nga MPPT/MTI, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- 1. N.P – 7 A (Ujësjetës, gazsjetës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje)
- 2. NP – 1 A (Punime gërmimi në tokë).

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Deklaratë nga administrata tatimore për xhiron mesatare vjetore të realizuar në vitin 2017, në vitin 2018 dhe në vitin 2019 nga subjekti, e cila duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 6.377.000 Lekë.

2.3 Per kapacitetin teknik:

1. Në lidhje me përvojën e mëparshme të suksesshme të Operatorit Ekonomik, kërkohet :

- a) *Operatori Ekonomik duhet të ketë kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- b) *Operatori Ekonomik duhet të ketë kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (lekë pa TVSH). ”*

Potësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike ,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8 ” Formular vlerësimi”, shoqëruar me:

2. Situacionin përfundimtar;

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e **shoqëruar** me fatura tatimore të shitjes, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve të ngjashme me objektin e tenderit ”

2. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt , shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Kontratë pune e vlefshme
b) Diplomë

3. Një punësim i të paktën mesatarisht 21 personave, për periudhën kohore Shtator 2020 – Dhjetor 2020 të vërtetuar me;

Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën Shtator 2020 –Dhjetor 2020.”

4. Kandidati ofertues duhet të paraqesë një Deklaratë për përmbushjen e volumeve të gërmimit me krahë , duke punësuar minimalisht 4 punëtorë .”

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me **kontratë pune të vlefshme** dhe **diplomë** , si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi;
b. 1 (një) Inxhinier Gjeodet;

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:

1	Hidraulik	3 persona
2	Karpentier	2 persona
3	Hekurthyes	1 person
4	Teknik të mesëm ndërtimi	1 person

Dokumenta Standarde të Tenderit

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) .

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe deshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë të leshuar nga DPSHTRR .

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) shofera . Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe leja e drejtimit leshuar nga DPSHTRR dhe certifikata e aftësisë profesionale.

9. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të cilësive ISO 9001:2015 (e vlefshme).

10. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme).

11. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomik certifikatat e mësipërme duhet të plotësohen nga të gjithë antarët sipas përqindjes së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës , sipas Shtojcës 10 "Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve".

Mjetet	Statusi	Sasia
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
Minifadrome me goma (bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetshkarkues me tonazhe të ndryshme	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë deri në 6 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Gjenerator 15 kW	në pronësi ose me qira	Copë 1
Pompë për largimin e ujrave nga kanali me kapacitet mbi 10 l/s	në pronësi ose me qira	Copë 1
Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (ivlefshëm).

Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (I vlefshëm). Mjetet të

Dokumenta Standarde të Tenderit

shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt I ketij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor UKKO SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10.

13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vetëdeklarim Sipas Shtojcës 11 te DT , që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

14. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Hartoi:

1. Ing. Ilir Papa

2. Ing. Mario Grabocka

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: Sipas dokumentave bashkangjitur të hartuar nga grupi i punës i ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike.

Specifikimet Teknike të Materialeve: :Sipas dokumentave bashkangjitur.

Grafiku i Punimeve: :Sipas dokumentit bashkangjitur.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: :Sipas dokumentave bashkangjitur.

SPECIFIKIME TEKNIKE PER ZBATIMIN E PROJEKTIT

**“ KANALIZIMET E UJRAVE TE PERDORURA NE RRUGET ‘KAJO KARAFILI”,
“FORE CUNOTI” etj NE QYTETIN E KORCES SI DHE DISA RRUGE NE FSHATRAT
DRENOVE DHE BOBOSHTICE NE NJ.A. DRENOVE.**

Zbatimi i punimeve të kanalizimeve të ujrave të përdorura për projektin KANALIZIMET E UJRAVE TE PERDORURA NE RRUGET ‘KAJO KARAFILI”, “FORE CUNOTI” etj NE QYTETIN E KORCES SI DHE NE DISA RRUGE NE FSHATRAT DRENOVE DHE BOBOSHTICE NE NJ.A. DRENOVE. duhet të jetë në përshtatje të plotë me KTZ (Kushtet Teknike të Zbatimit) si dhe standartet për “Ndertimin dhe provat e drenazheve dhe kanalizimeve të ujrave të përdorura “.

I – Hapja e kanalit ku do të vendosen tubacionet.

Kanali hapet në vijë të drejtë sipas drejtimit të përcaktuar në projekt. Thellësia e tij duhet të jetë jo më pak se 10cm nën tubin që do të vendoset. Kanali pastrohet plotësisht dhe nuk duhet të ketë në të gurë ose mbetje të tjera mekanike. Fundi i kanalit duhet të jetë i gjerë jo më pak se 70cm plus diametrin e jashtë të tubit. Këndi i ngritjes tërthore të kanalit deri në 15 gradë.

II – Vendosja e tubove.

Para se të vendoset tubi në kanal, në bazën e tij duhet të hidhet 10cm shtresë uniforme me rërë të imët. Mbi këtë shtresë vendoset tubi. Niveli i çdo tubi do të përcaktohet gjithmonë me instrument topografik. Ky proces është i domosdoshëm për të garantuar vetrrijdhjen dhe shpejtësinë e prurjeve të llogaritura në projekt. Më pas kanali mbushet përsëri me rërë të imët deri 20cm mbi pjesën e sipërme të tubit. Pas këtij procesi hidhen rikthime (dhe) në shtresa nga 30cm. Çdo shtresë duhet të ngjshet me rul. Kompaktesimi i shtresave (gjate mbulimit te tubit) do te kryhet me tokmak elektrik (cdo 30cm),duke eliminuar goditjen direkte mbi tub ne 30cm e pare. Mbushja e kanalit dhe gjendja e mirë teknike e tij do të quhet e rregullt pasi të rezultojë me sukses prova e penetrimit (me ngarkesë goditëse 3Kg) si dhe prova e qëndrueshmërisë. Tubat lidhen njëri pas tjetrit me gomina hermetizuese. Lidhja me ngjitje ose me gomina duhet të jetë në përshtatje me standartin dhe t'i rezistojë presionit 0,5 bar. Tubat gjatë transportit, shtrirjes dhe lidhjes nuk duhet të pësojnë deformime ose çarje. Gjatë vendosjes së tubacioneve duhet të kryhen matje topografike për të garantuar pjerrësitë e përcaktuara në projekt.

Materialet mbushese nuk duhet te kene gure ose ndonje material tjetër te fortë qe ka dimensione 150 mm, ne asnje drejtim.

Kanalet ne siperfaqe do te jene te risistemuara me materiale te njejta si siperfaqja origjinale e shtruar pasi Inxhinieri ka rene dakort qe instalimi eshte kompletuar. Anet e risistemimit do te priten ne vija te drejta para se te jepet dora e fundit e rregullimit.

Atje ku eshte e mundur, do te perdoren materialet e zgjedhura nga germimi, dhe te hiqen guret me madhesi mbi (>35mm) ose ndonje objekt tjetër i fortë. Te gjithë materialet do te vendoset dhe do te ngjeshen me dore ose me ngjeshes mekanik te pershtatshem; kg/m3.

Fundi i kanalit duhet te jete i qendrueshem.

III - Tubacionet

Tubat duhet të jetë korrugato të klasës SN 8 (8 KN/m²) të provuara në laborator sipas standartit prEN 13476 – 1. Guarnicionet që lidhin tubot duhet të jenë në përshtatje me standartin. Prova e hermeticitetit duhet të jetë konform standarteve DIN EN 1610.

Emertimi **DN** i referohet diametrit te brendshem te tubit.

Tubat e korruguara (DN300, DN400) jane me mure te dyfishta: muri i jashtem me rebra dhe muri i brendshem me sip te lemuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyre te zeze kurse shtresa e brendeshme duhet te jete me ngjyre te celur.

Gjatesia e tubove duhet te jete 6.0 ml.

Per lidhjet e shtepive dhe pusetave te shiut do te perdoren tubo pvc160mm, se bashku me rakorderite perkatese (bryla te ndryshem, Ta etj).

Guarnicionet bashkues (Dn160) do te perdoren per lidhjen e tubacionit PVC DN 160, pra lidhjes se objektit me tubacionin kryesor (DN300 ose DN400) dhe sherben per fiksimin dhe hermetizimin e tubit PVC me tubin e korruguar. Kendi i takimit te tubit PVC me tubin e koruguar do te jete 90 grade (deri + 30 grade sipas drejtimimit te rrjedhes).

Tubat që do të përdoren duhet të jenë të pajisura me çertifikatat përkatëse që vërtetojnë cilësinë e tyre.

IV – Pusetat e kontrollit b/a

Do të realizohen prej betoni të armuar. Ato do të realizohen me beton të armuar duke lënë sipër një vrimë rrethore me diametër rreth 80cm e cila mbyllet me suport dhe kapak gize me diametër 60cm. Lartësia e pusëtës llogaritet duke mbetur kapaku i gizës në nivelin e sipërfaqes përfundimtare të shtresave të rrugës.

Te gjitha punimet e betonit që do të kryhen për strukturat e pusëtave, do të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standartet shqiptare.

Shufrat e armimit duhet të ruhen dhe duhet të mbrohen me materiale kundër ndryshkut, demtimeve vajit ose agjenteve të tjera shkatërrues.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e të gjithë shufrave të kërkuar nga Inxhinieri dhe të japë garanci për saktësinë para prerjes dhe lidhjes së hekurit të armuar.

Perzjerresit do të përdoren vetëm me një aprovim me shkrim të Supervizorit, me qëllim që të modifikohen karakteristikat e betonit dhe të arrihen rezultatet

Markat e betonit të përdorura në Punime do të jenë sipas kërkesës ose me këshillat e Supervizionit.

Kallepet

Te gjithë skeletet, kallepet, mbështetësit, dhe vend kalimet do të jenë të një cilësie të përshtatshme dhe me të tillë fortësi që të jenë perseri rigjide pa lënë ndonjë shtremberim ose ndryshim gjatë gjithë formës gjatë vibrimit dhe ngjeshjes së betonit. Drure ose derrasa me një trashësi me të vogël se 20 mm nuk do të përdoren pa një aprovim specifik të Supervizorit. Te gjithë lidhjet e kallepeve duhet të jenë me mbyllje të përshtatshme për të shmangur humbjen e materialeve të imta ose të llacit gjatë hedhjes dhe konsolidimit të betonit. Forma e kallepit duhet të jetë e projektuar e tillë që të mund të lejojë levizjen e tij pa demtuar betonin.

Kontraktori do të duhet të japë një njoftim Supervizorit 24 orë më parë për të hequr çdo kallep. Pasi betoni është formuar, kallepet duhet të hiqen me shumë kujdes, pa goditje ose ndonjë prishje, në mënyrë që betoni të mos të demtohet. Asnjë kallep nuk duhet të hiqet para se betoni të jetë formuar plotësisht për të shmangur çdo prishje të strukturës së betonit. Në përgjithësi, betoni do të konsolidohet me vibratore elektrik ose pneumatik. Vibrimi i cili shkakton ndarje të përberësve ose një sipërfaqe të ujezuar, ose e cila sjell një sasi të madhe të njomjes në sipërfaqe duhet të shmanget.

Te përgjithshme

Për të gjithë llojet e pusëtave bazamenti dhe kapaku prej gize duhet të jenë sipas standartit: klasa D400 EN 124 NF GS.

Për të gjitha pusetat e kontrollit, për kapaket, rekomandohet tipi me ventilim, me menteshe, me diametër të jashtë 610mm dhe lartësi 100mm.

Vendosja e tubacioneve, pusëtave të kontrollit duhet të sigurojnë hermeticitet të plotë të këtij sistemi kanalizimesh.

Nuk duhet të kryhen ndryshime të projektit gjatë zbatimit të tij. Në rastet kur është e domosdoshme duhet që këto të miratohen me shkrim nga klienti dhe supervizori i punimeve.

Standartet

Materialet dhe paisjet do të jenë sipas standarteve kombetare ose nderkombetare të aprovuara.

Te gjitha materialet dhe komponentet perberese do të jenë të certifikuara sipas Standarteve të nje Vendi Anetar të Bashkimit Europian, ose Shqiptare dhe të gjitha prodhimet do të jenë konform Standarteve Kombetare të ngjashme ose Kodet Praktike. Kontraktori mund të propozojë standarte alternative kombetare të alternativave të propozuara të cilat duhet t'i paraqiten Supervizorit për rishikim dhe aprovim. Një kopje e të gjithë standarteve të aprovuara do të mbahen në Kantier nga Kontraktori. Neqoftese nuk ka Specifikime të Standarteve të publikuara, materialet dhe prodhimet do të jenë nga standartet me të mira të pershtatshme dhe do të jenë subjekt për aprovim nga Supervizioni. Kur punimet e propozuara lidhen me rrejtet ekzistuese materialet e reja do të jenë të pershtatshme me ato ekzistueset.

Paketimi për Transport, Ruajtja dhe magazinimi

Perpara dergimit prej fabrikes ne objekt të gjitha materialet do të jenë të mbrojtura mjaftueshem me menyra të aprovuara për të gjithë periudhën e tranzitit, magazinimit, si dhe të eliminohen demtime aksidentale. Kontraktori do të jetë përgjegjës për paketimin nga fabrika, për mbrojtjen në menyre që materialet të arrijnë në vend të pa demtuara. . Shkarkimi do të bëhet nga kontraktori (për shkarkimin e materialeve të furnizuara në vend ose magazine) dhe ai është përgjegjës për ndonjë demtim.

Magazinimi në vend dhe mbajtja duhet të realizohen në menyre sa më të sigurte të jete e mundur, dhe materialet që do të magazinohen të hapura në vend të mos demtohen (Sigurimi i nje magazine të aprovuar, mund të shihet si alternative)

Ngarkimi dhe shkarkimi do të bëhen ngadalë me paisje të pershtatshme dhe tubacioni duhet të jetë nën kontroll gjatë gjithë kohës. Në asnjë rast nuk duhet që tubacioni të perplasë ose të hidhet nga lartësia. Në çdo rast duhet të perdoren rekomandimet e prodhuesit të tubave.

Inspektimi i Vendit

Para përgatitjes për të filluar punimet (në se kerkohet) Kontraktori do të vizitojë Objektivin dhe do të verifikojë gjendjen aktuale në krahasim me vizatimet e përgatitura, duke kontrolluar të gjithë dimensionet e rëndësishme, rruget e hyrjes, gjendjen e objektit dhe kërkesat në menyre që të sigurohet se të gjithë materialet dhe fuqia punetore do të arrijnë plotësisht sipas parashikimit të vizatimeve dhe Kontrates.

Perpara fillimit të punës Kontraktori do të ekzaminojë dhe të bëjë organizimin me Supervizionin që paisjet të instalohen pa ndërhyrje me punët në vazhdim të konstruksionit dhe mund të shpërndajë në vend të gjitha materialet e listuara të kerkuara.

Kontraktori do të instruktrohet nga stafi i Supervizionit, për të marrë përgjegjësitë në të gjitha ceshtjet dhe gjerat që kanë të bëjnë me operimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe materialeve në kushte të pershtatshme.

Mbrojtja e shërbimeve dhe e veprave ekzistuese

Kontraktori do të njihet me pozicionin e të gjithë shërbimeve ekzistuese të tilla si rrjeti i ujësjes, lidhjet e banesave, sistemet ujëtare, drenazhet dhe kanalet e kullimit të ujërave sipërfaqësore, kabllat elektrike dhe të telefonit, shtyllat telefonike dhe të ndriçimit, tubacionet dhe të ngjashme me to përpara se të fillojë ndonjë germim ose punë tjetër që mund të ndikojë këto shërbime. Kontraktori do të konsiderohet përgjegjës për dëmtimet e veprave dhe shërbimeve ekzistuese, dhe do të çdëmtojë Punëdhënësin për çdo ankese në lidhje me këto (duke përfshirë humbjet që pasojnë). Kontraktori do të jetë përgjegjës për risjelljen në gjendjen e mëparshme të shërbimeve që janë ndikuar.

Në të gjithë rastet kur këto vepra ose shërbime janë ekspozuar, ato duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme, mbeshteten ose mbrohen në ndonjë mënyrë tjetër.

Kujdes i veçantë duhet ushtruar në mbushjen dhe ngjeshjen e tokës në tubacionet kryesore të rrjetit të ujësjes, kabllot, kanalet ujëtare etj. dhe të lihen të pa mbuluar çdo matës uji i ekspozuar, pusete valvole, dhe të tjera si këto. Gjithë kostot që mund të rezultojnë nga Kontraktori si rezultat i punës programuese koordinuese për të bërë të mundur të bëhet çdo ndryshim këtyre shërbimeve, dhe kosto e çdo masë parandaluese do të gjykohen nga Supervizori nëse është e nevojshme, në saj të afersisë së veprave nga çdonjëra nga shërbimet e kontraktorit. Disa nga detajet e kryqezimeve me infrastrukturen e lartpërmendur do të jepen me vizatime.

Shmangia e shërbimeve ekzistuese

Menjëherë pasi kërkesa është e bërë e njohur, kontraktori do të jetë përgjegjës për organizimin, në bashkëveprim me autoritetet përkatëse, për levizjen ose alterimin (ndryshimin) e shërbimeve ekzistuese të tilla si linjat elektrike dhe telefonike, linjat kryesore të ujit të pijshëm, tubacionet, kanalet ujëtare, dhe drenazhet e ujit sipërfaqësor, të cilat ndikohen nga vepra. Organizimi për një levizje ose alterim (ndryshim) të tilla do të jetë me kusht të rënies dakord me Supervizorin dhe me autoritetet përkatëse në zërat e çmimeve të preventivit; në këto kuader devijimi i shërbimeve ekzistuese nuk do të jetë subjekt i ndryshimit të çmimit total të kontratës.

Të gjitha materialet, punimet e tokës, shtrimi, lidhjet dhe rakorderite dhe prova e tubacioneve do të plotësojnë me detaje të gjithë kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Të gjitha materialet duhet të jenë të reja dhe të papërdorura.

Të gjitha tubat dhe rakorderite duhet të jenë të inspektuara me kujdes, në kohën që arrijnë në objekt nga Kontraktori. Çdo material me defekt duhet të vendoset menjëherë për inspektim nga Supervizori; ato duhet ose të riparohen ose të zëvendësohen sipas instruksionit të dhënë nga Supervizori.

Të gjithë defektet do të jenë të identifikuara dhe do të riparohen me shpenzimet e Kontraktorit.

Hartoi :

Ing. Ilir Papa

Ing. Mario Grabocka

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

P R E V E N T I V

**Ndërtim rrjeti i kanalizimit në Rrugët "Kajo Karafili", "Fore Çunoti" etj.
(Lagjia 5 dhe 13)**

Nr.	Nr. Analize	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESI	SASI	ÇMIMI leke	VLERA leke
1	3.89/a	Germim dheu me eskavator goma 0,25m ³ ne kanale me gjeresi deri 2 m, toke e zak, kat III me shkarkim ne mjet	m ³	1570		
2	3.25/b	Germim dheu me krahe seksion detyruar me gjeresi b<1 m h=1,5 m toke e zak	m ³	50		
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	1620		
4	3.An/2t	Furnizim vendosje tub korrugato HDPE,SN8. DN400. ID	ml	100		
5	3.An/1t	Furnizim vendosje tub korrugato HDPE, SN8. DN300. ID	ml	760		
6	2,522	Furnizim vendosje tub P.V.C DN 160 (me rakorderi, bryla te ndryshem, Ta, etj.)	ml	630		
7	An.	Guarnicione bashkues DN160 (per lidhjet e objekteve me tubacionin kryesor)	cope	125		
8	2,261	Shtrese rere poshte tubit dhe mbulimi i tubit me rere(deri 20cm mbi tub)	m ³	690		
9	An-18	Puseta shkarkimi b/a, 0,5x0,5x1.5m, me kapak gize	cope	9		
10	An-21	Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize	cope	12		
11	3,353	Mbushje me shkemb te germuar me pare	m ³	690		
12	3.212/d	Shtrese stabilizanti t=20 cm	m ²	1230		
		SHUMA				
		Fondi rezerve 5%				
		TOTALI ne leke pa TVSH				

P R E V E N T I V
Ndërtim linje kanalizimi në fshatin Boboshticë

Nr.	NR.analiz e	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESI	SASI	ÇMIMI leke	VLERA leke
1	3/87/a	Germim dheu kanal me makineri	m ³	230		
2	3.An/1t	F,V tubo te brinjezuar HDPE, SN8, DN315	ml	140		
3	2/522	Furnizim vendosje tub p.v.c DN 160 (me rakorderi ,bryla te ndryshem,Ta,etj)	ml	60		
4	An	Guarnicione bashkues DN160 (per lidhjet e objekteve me tubacionin kryesor)	cop	12		
5	2.261	Shtrese rere poshte tubit dhe mbulimi i tubit me rere(deri 20cm mbi tub)	m ³	55		
6	An-21	Puseta shkarkimi b/a,1x1x1.5m,me kapak gize	cop	8		
7	3.47/1b	Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30cm	m ³	165		
		SHUMA				
		Fond rezerve 5%				
		TOTALI ne leke pa TVSH				

P R E V E N T I V
Ndërtim linje kanalizimi në fshatin Drenovë

Nr.	Nr. Analize	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESI	SASI	ÇMIMI leke	VLERA leke
1	3.87/b	Germim dheu kanal me makineri me shkarkim ne toke	m ³	1400		
2	3.An/1t	Furnizim vendosje tub korrugatoHDPE,SN8. DN300	ml	1030		
3	2,522	Furnizim vendosje tub P.V.C DN 160 (me rakorderi, bryla te ndryshem, Ta, etj.)	ml	520		
4	An.	Guarnicione bashkues DN160 (per lidhjet e objekteve me tubacionin kryesor)	cope	104		
5	2,261	Shtrese rere poshte tubit dhe mbulimi I tubit me rere(deri 20cm mbi tub)	m ³	556		
6	An-21	Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize	cope	13		

Dokumenta Standarde të Tenderit

7	3.47/1b	Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30cm	m ³	844		
		SHUMA				
		Fondi rezerve 5%				
		TOTALI ne leke pa TVSH				

Preventivi Permbledhes

Nr	Fshati	Shuma ne leke pa TVSH	Fondi Rezerve 5% , ne leke	Shuma ne leke pa TVSH
1	Ndërtim rrjeti i kanalizimit në Rrugët "Kajo Karafili", "Fore Çunoti" etj. (Lagjia 5 dhe 13)			
2	Ndërtim linje kanalizimi në fshatin Boboshticë			
3	Ndërtim linje kanalizimi në fshatin Drenovë			
	SHUMA ne leke pa TVSH	_____		
	Totali Fondi rezerve 5%		_____	
	TOTALI ne leke pa TVSH			_____
	TVSH 20%			_____
	TOTALI ne leke me TVSH			_____

Hartoi :

Ing. Ilir Papa

Ing. Mario Grabocka

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon në objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

